

967 EMËR GJEOGRAFIK SI EMËRTIM LËNDOR (VARIANTI)*

Fusha 967 përmban variantin e emërtimit lëndor për emrin gjeografik të vendosur në fushën 607.

Nënfushat & përsëritshmëria

| FUSHA/NËNFUSHA | | PËRSËRITSHMËRIA |
|----------------|---|-----------------|
| 967 | Emër gjeografik si emërtim lëndor (varianti)* | r |
| a | <i>Elementi hyrës</i> | nr |
| x | <i>Përcaktuesi tematik</i> | r |
| y | <i>Përcaktuesi gjeografik</i> | r |
| w | <i>Përcaktuesi i formës</i> | r |
| z | <i>Përcaktuesi kohor</i> | r |
| 2 | <i>Kodi i sistemit</i> | nr |
| 6 | <i>Të dhënat për lidhjen</i> | nr |

Treguesit

| TREGUESI | VLERA | KUPTIMI |
|----------|-------|--|
| 1 | | <i>Treguesi për shfaqjen</i> |
| | □ | <i>Nuk ka vlerë</i> |
| | 0 | <i>Nuk shfaqet**</i> |
| | 1 | <i>Fusha shfaqet për nevojat e katalogut**</i> |
| | 2 | <i>Fusha shfaqet për nevojat e bibliografisë**</i> |
| | 3 | <i>Fusha shfaqet për nevojat e katalogut dhe bibliografisë**</i> |
| 2 | | <i>Nuk është i përcaktuar</i> |

PËRSHKRIMI I NËNFUSHAVE

Për të gjitha nënfushat vlejné udhëzimet e përshkruara tek fusha 607 (shih përshkrimin e fushës 607).

SHËNIME PËR PËRMBAJTJEN E FUSHËS

Fusha përdoret për vendosjen e varianteve të atyre emërtimeve lëndore, të cilat nuk janë të lidhura me regjistrimet e njësuara. Vendoset forma, e cila ndryshon nga forma në fushën 607. Kërkimi bëhet njëherësh në fushat 607 dhe 967.

Nënfusha 6 – *Të dhënat për lidhjen*, e cila përdoret për lidhjen e të gjitha formave të emërtimeve lëndore, është e detyrueshme (shih shembujt 1, 2). Fusha 607 lidhet me fushën përkatëse 967 duke vendosur në të dyja fushat numër të njëjtë (01–99) në nënfushën 6. Nëse fushës 607 i takojnë disa fusha 967, në të gjitha nënfushat 6 të fushave përkatëse 967 vendoset numri i njëjtë.

FUSHAT NË LIDHSHMËRI

607 EMËR GJEOGRAFIK SI EMËRTIM LËNDOR

Forma e njësuar e emërtimit lëndor nga fusha 967.

SHEMBUJ

1. * COBISS.net

| | | |
|-----|----|---|
| 200 | 0□ | a Bibliotekarja nga Auschwitz f Antonio Iturbe g [përktheu Manica Basha] |
| 607 | □□ | a Oświęcim x Kamp përqëndrimi 2 NUK 601 |
| 967 | □□ | a Auschwitz 2 NUK 601 |

2. * COBISS.net

| | | |
|-----|----|--|
| 200 | 1□ | a Shteti i së drejtës – përvoja evropiane f Ardit Stafa |
| 607 | □□ | a Shtetet Ballkanike x Sistemi ligjor 2 CG 601 |
| 967 | □□ | a Vendet e Ballkanit 2 CG 601 |
| 967 | □□ | a Ballkani 2 CG 601 |